

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

1. OBJEKTI I PROCEDURËS:

BLERJE MATERIALE SINJALISTIKE

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

34992200-9

VLERA E FONDIT LIMIT:

7 498 060(shtatë milion e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë gjashtëdhjetë) Lekë pa TVSH.

Bazuar në nenin 76 pika 3 të VKM 285 datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik” e ndryshuar, në zbatim të urdhërit të titullarit, për ngritjen e komisionit për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës për procedurën e prokurimit komisoni pasi u njoh me objektin e prokurimit, bazuar në VKM 285 datë 19.05.2021 neni 76, bazuar ne manualin e cmimeve te ndertimit 2023 nga portali e-albania ka bërë përlogaritjen e vlerës limit te kontrates për sinjalistikën rrugore.

Vlerat për sinjalistikën detare janë llogaritur nepermjet manulait te cmimeve te materialeve te ndertimit 2023 nga portali e-albania.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoritet kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Në zbatim të nenit 83 te Ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020) është 2% e fondit limit.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas Shtojcës 8.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve e fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" te ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: " Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata".*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" te ndryshuar, ku përcaktohet se c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetare, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme."

Sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës Procedurë e hapur të thjeshtuar, edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2 (c) e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

2.2.2.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025

ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit

Argumentimi: *Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitet financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2025, nga organet e qeverisjes vendore për pikat ku ushtrohet aktiviteti sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024; në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3 Kapaciteti Teknik

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për kontrata të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nën 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar duke qënë se vlera e fondit limit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.*

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën ISO 14001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Mjedisit” / ose ekuivalent (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: *Ky kriter është vendosur në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenit 40 dhe nenit 44, të VKM-se Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.*

Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar mallrat objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin e shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi

i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik lidhur me përvojën e duhur, vërtetuar kjo edhe nëpërmjet dokumentave si çertifikata ISO e cila është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar suksesin e kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit/skeden teknike ku të jenë të paraqitura të dhënat teknike për mallrat objekt prokurimi në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Argumentimi: *Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve /broshurës/ skedës teknike është një kërkesë proporcionale dhe ngushtësisht e lidhur me objektin e prokurimit pasi i jep mundësinë Autoritetit Kontraktor për verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të hartuara nga Autoriteti Kontraktor.*

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i autorizuar për mallrat e ofertuara ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose te distributorit te autorizuar.

Ne rast se do te paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar duhet te vertetohet lidhje midis distributorit te autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: *Autorizimi i prodhuesit është dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kriteri është hartuar në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Në këtë kontekst, është garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter lidhet gjithashtu me cilësitë e artikujve dhe nevojës për garanci mbi eficientë dhe kapacitetet teknike të secilit zë.*

2.3.5 Në menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara, operatori ekonomik duhet te paraqese mostra për mallrat objekt prokurimi me numer rendor 1, 8, 12(referoju artikujve sipas shtojcës 7).

Ky kriter I shërben Autoritetit Kontraktor për verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike dhe cilësisë që ato duhet të kenë.

Argumentim: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 6 gërma a, tënenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullavete Prokurimit Publik”, ne tecilen eshte e percaktuar se: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor për cakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces.*

Shënim: Mosparaqitja e mostrave sipas specifikimeve teknike të kërkuara përbën kusht skualifikimi.

SPECIFIKIME TEKNIKE

1 Tabelat

- a) Materiali tabelave duhet te jete prej llamarine hekuri , me spesor jo me pake se 1 mm ose me llamarine aliazhi , jo me pake se 2.5 mm. Cdo sinjal duhet te jete I perforcuar ne te gjithë perimetrin e tij me nje bordure te kthyer . Te gjithë sinjalet ne pjesen e pasme duhet te permbajne element konstruktive te cilet te bejne te mundur mberthimin e saj ne bishtin e tabelës . Shenjat me siperfaqe me te madhe se 0.8 m² , disqet dhe trekendeshat me diameter 90 cm , shenjat drejtuese etj , duhet te kene element perforcues ne pjesen e pasme te tyre ne te gjithë gjatesine . Pjesa perforcuese duhet te jete e pershtatshme per te reshqitje dhe mberthim ne te gjithë gjatesine stafave monmtuese , ne mbajtese te shenjes .Tabelat te plotesojne standarte EN 12899-1;2007 ose ekujvalent

Lidhjet e tabelës me mbajtësen : Cdo table duhet te lidhet ne pjesen e siperme dhe te poshtme te saj , me mbajtësen duke garantuar soliditetin me nje numer te

mjaftueshme te bullonave prej celiku te xinguar ne pjesen e pasme te tabelës . Seti I atrecatures per kapjen e tabelës perbehet nga kapsja metalike me dhembin per montimin ne tubin me kanal , 2 bulona dhe 2 dado

b) Tubi tabelës duhet te jete me kanal , Ø 60, prej matteriali hekur te galvanizuar

c) Adezivi :

Adeziv me intesitet te larte per sinjalistike rrugore, te perhereshme dhe /ose te perkoheshme , I qendrueshem material mikroprismatik retroreflektiv .Materiali mikroprismatik qe siguron shkalle te larte retroreflektiviteti (dukshmerie) per menaxhimin e trafikut rrugor ditën dhe natën.

Ka te njejten shkalle retroreflektiviteti (dukshmerie) ditën dhe natën ne te gjithë anët , pavaresisht orientimit te tabelës .

Performanca : Sipas standartit nderkombetar ASTM D4956 dhe standartit European CUAP

Qendrueshmeria : 10 vjet

Pamja : Shtresa retroreflektive akrelik me shkelqim te larte , me mikroprizma

Adezivi : Sensitiv ndaj shtypjes

Shtresa : Material Polipropilen

Shtypja/printimi : I thjeshte , Ultraviolet ,termal

Aplikimi

- Per sinjalistike rrugore te perhereshme dhe /ose te perkoheshme ;
- Pajisje plastike te punës ;
- Pajisjet e sigurise qe kerkojne shkalle te larte reflektiviteti(dukshmerie)
-

Retroreflektiviteti

Tabela A

Koeficientet minimal te refloreflektiviteti (dukshmerise) (RAI), sipas standartit nderkombetar ASTM D4956 Tipi III§ IV

Kendi vëzhgimit	Ngjyra	Kendi I hyres I drites	
		- 4 °	+ 30 °
	Bardhe	500	240
	Verdhe	380	175
	Portokalli	200	94

	Blu	42	20
0.1°	Jeshile	70	32
	Kuqe	90	42
	Kafe	25	12
	Verdhe fosforeshente	300	140
	Verdhe Jeshile fosforeshente	400	185
	Bardhe	360	170
	Verdhe	270	135
	Portokalli	145	68
0.2°	Blu	30	14
	Jeshile	50	25
	KUQE	65	30
	Kafe	18	8.5
	Verdhe fosforeshente	220	100
	Verdhe Jeshile fosforeshente	290	135
	Bardhe	150	72
	Verdhe	110	54
	Portokalli	60	28
	Blu	13	6.0
0.5°	Jeshile	21	10
	Kuqe	27	13
	Kafe	7.5	3.5
	Verdhe fosforeshente	90	40
	Verdhe Jeshile fosforeshente	120	55

Tabela B

Koeficientet minimal te retroreflektivitetit (dukshmerise)(RAI) sipas standartit European CUAP (EN -12899 RA 2 ose S SH –EN 12899)

Kendi I vezhgimit	Ngjyra	Kendi hyres I drites β_1 ($\beta_2=0^\circ$)	+30°	+40°
		+5°		
	Verdhe	250	150	110

	Verdhe	170	100	70
	Portokalli	100	60	29
	Blu	20	11	8
12°(0.2°)	Jeshile	45	25	12
	Kuqe	45	25	15
	Kafe	12	8.5	5.0
	Bardhe	180	100	95
	Verdhe	120	70	60
	Portokalli	65	40	20
20°(0.33°)	Blu	14	8.0	7.0
	Jeshile	21	12	11
	Kuqe	25	14	13
	Kafe	8.0	5.0	
				3.0
	Bardhe	5.0	2.5	1.5
	Verdhe	3.0	1.5	1
	Portokalli	1.5	1	-
	Blu	0.2	-	-
2°	Jeshile	0.5	0.3	0.2
	Kuqe	1	0.4	0.3
	Kafe	0.2	-	-

Parametra te ngjyres; Diten

Shtresa retroreflektive (celuloide) Mikroprismatike me intesitet te larte (HIP) (Adeziv CL2) permbushin kerkesat e e ngjyres ditën bazuar ne percaktimet e stndarteve ASTM D 4956 dhe CUAP sipas tabelës se mëposhtme:

Ngjyra	Shkelqimi sipas CUAP	Hkelqimi sipas ASTM (Y%)	Shkelqimi sipas ASTM(Y%)
		Min	Max
Bardhe	≥ 0.40	27	-
Verdhe	≥0.24	15	45
Portokalli	≥0.14	10	30
Blu	≥0.01	1	10
Jeshile	≥0.03	3	12
Kuqe	≥0.03	2.5	15
Kafe	0.04≤β≤0.06	1	*
Verdhe fosforeshente	≤0.38	10	-
Verdhe Jeshile fosforeshente	≤0.70	60	-

--	--	--	--

Parametrat e ngjyres :naten

Kendi vezhgimit 0.33 grade, kendi I hyrjes se drites prej +5 grade

Tabela 2; kromaticiteti gjate dites dhe faktori I Luminances A

Ngjyra		Kordinatat e kutise se ngjyrave				Faktori luminance β
		1	2	3	4	
Bardhe	X	3.355	0.305	0.285	0.335	0.27
	Y	0.355	0.305	0.325	0.375	
Verdhe	X	0.545	0.487	0.427	0.465	0.16
	Y	0.454	0.423	0.423	0.534	
Kuqe	X	0.735	0.674	0.569	0.655	0.03
	Y	0.265	0.236	0.341	0.345	
Portokalli	X	0.631	0.560	0.506	0.570	0.14
	Y	0.369	0.360	0.404	0.429	
Jeshile	X	0.007	0.248	0.177	0.026	0.03
	Y	0.703	0.409	0.362	0.399	
Jeshile2 (Ëorboy Green)	X	0.313	0.313	0.248	0.127	0.01 ---- 0.07
	Y	0.682	0.453	0.409	0.557	
Kafe	X	0.455	0.523	0.558	0.479	0.01---- 0.09
	Y	0.397	0.429	0.394	0.373	
Blu	X	0.078	0.150	0.210	0.137	0.01
	Y	0.171	0.220	0.160	0.038	
E Zeze	X	0.385	0.300	0.260	0.345	0.03
	y	0.355	0.270	0.310	0.395	

Tabela 3: koeficientet e retroreflektimit $1,RA$ (cd/lux/m²)

Kendi I hyrjes se drites ($\beta_1, \beta_2=0^\circ$)	Kendi vezhgimit (α)	Bardhe	Verdhe	Portokalli	Jeshile	Kuqe	Blu	Kafe	Ëorboy green
145°	0.2°	360	270	145	50	65	30	18	20
30°		170	135	68	25	30	14	8.5	15
5°	0.33	180	120	65	21	25	14	8	14

30°		100	70	40	12	1 4	8	5	11
5°	0.5°	150	110	60	21	2 7	13	7.5	7.5
30°		72	54	28	10	1 3	6	3.5	3.5
5°	1.0°	35	26	12	4	5.2	2	1	1
30°		20	15	6.8	2	3	1	0.6	0.6

Tabela 4: Koeficientet retroreflektivitetit 2,RA (cd/lux/m2) (Perfshire RA2/R2)

Kendi I hyrjes drites (β1, B2=0°)	Kendi vezhgimit (α)	Bardhe	Verdhe	Portokalli	Jeshile	Kuqe	Blu	Kafe	Ëorboy green
5°	0.2°	250	170	100	45	4 5	20	12	20
30°		150	100	60	25	2 5	11	8.5	15
40°		110	70	29	12	1 5	8	5	6
5°	0.33°	180	120	65	21	2 5	14	8	14
30°		100	70	40	12	1 4	8	5	11
40°		95	60	20	11	1 3	7	3	5
5°	2.0°	5	3	1.5	0.5	1	0.2	0.2	0.5
30°		2.5	1.5	1	0.3	0 4	-	-	0.3
40°		1.5	1	-	0.2	0 3	-	-	0.2

KARAKTERISTIKAT

Jetegjatesia	1 vit nga data e blerjes kur mbahet ne kushtet si ne vijim : 65°- 75° F (18° 24° C) dhe 50%± R.H
---------------------	--

Temperatura minimale e aplikimit	50° F(10° C)
Temperatura e sherbimit	-10° Fto+150°F(-23° C to +65° C
Printimi I thjeshte	Qendrueshmeri afatgjate e shtresave te printuara te kombinuara me serite HIP eshte e garantuar kur perdoret boje printer dhe shtrese (veshje) e aprovuar.
Printimi me solvent Shtypja (printimi) ultraviolet	Qendrimi afatgjate e printimt solvent /ultraviolet te kombinuara me serite HIP eshte e garantuar kur perdoret boje dhe printer I aprovuar
Printim termal	Qendrueshmeri afatgjate e printimit termal ne kombinim me cdo shtrese(CELULOID) HIP eshte egarantuar kur perdoren shirita dhe printera te aprovuar

Ngadalsues shpejtesie H=cm

Permasat : 60cm x 50cm x 5 cm

Pesha 15- 20 kg/copa

Perpberja : Elemente modulare gome te vullkanizuar ,(jo kallcuk) me pjese reflektuese te petezuar elastoplastic te verdhe.

Pamja Reflektive gjate gjatesise se saj

Ngjyra e verdhe dhe e zeze

Permasa fundore ne cm :

Fundore mashkull 30 x 60 x5 h

Fundore femer 30 x 60 x 5 h

Argumentimi i specifikimeve teknike: Specifikimet teknike jane hartuar nga specialistët e fushës, pjesë e DST.

Specifikimet teknike të hartuara për këto artikuj janë bazuar në nevojat konkrete të terrenit, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për sigurinë rrugore.

Specifikimet teknike për konet sinjalistike janë përcaktuar duke marrë në konsideratë garantimin e fleksibilitetit dhe rezistencës ndaj goditjeve pa u dëmtuar rezistences ndaj kushteve atmosferike, të qëndrueshme ndaj rrezeve UV, temperaturave të larta dhe të ulëta.

Elementë reflektues: për rritjen e dukshmërisë gjatë natës dhe në kushte me ndriçim të ulët.

Këto karakteristika janë të domosdoshme për të garantuar sinjalizim të qartë dhe të sigurt në situata emergjente, punime në rrugë apo devijime trafiku.

Specifikimet për tabelat rrugore janë hartuar duke u bazuar në materialin për rezistencë ndaj korrozionit dhe jetëgjatësi.

Veshje reflektuese për dukshmëri optimale gjatë natës, rezistence mekanike dhe ndaj kushteve atmosferike.

Tabelat rrugore duhet të jenë të lexueshme në çdo kohë dhe të qëndrueshme në afat të gjatë, për të garantuar orientim të saktë të përdoruesve të rrugës dhe ulje të rrezikut të aksidenteve.

Specifikimet teknike të hartuara për materialet e sinjalistikës rrugore janë në funksion të rritjes së sigurisë rrugore përmirësimit të menaxhimit të trafikut, sigurimit të qëndrueshmërisë dhe jetëgjatësisë së materialeve, përputhshmërisë me standardet teknike.

Këto specifikime janë të domosdoshme për të garantuar cilësi, funksionalitet dhe eficiencë.

Specifikimet teknike, për procedurën objekt prokurimi, shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e mallit dhe lidhen ngushtë me natyrën e kontratës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo specifikim dhe standard të kërkuar.**

NJESIA E PROKURIMIT